

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“CREATIVE HEART FILMS” SH.P.K**

Sot, më datë 13/11/2024 (dy mijë e njezet e kater), Z Taulant Skëndaj , shtetas shqiptar, i datëlindjes 22/07/1982, lindur ne Librazhd dhe banues ne rrethin Tiranes, bashkia Tirane , rruga Bajram Allaraj nd 145 ,H 1 ,ap-2 person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartes se identitetit me ID I20722104S vendosa te themeloj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat vijuese.

**NENI 1**  
**Themelimi**

Emri i shoqerise eshte " **CREATIVE HEART FILMS Sh.P.K**, Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri" **CREATIVE HEART FILMS " SH.P.K**, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

**NENI 2**

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë. Eshte fitim prures .fusha e veprimtarise eshte kryesisht ne krijimin dhe menaxhimin e filmave.Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie eshte veprimtari artistike, etj .

**NENI 3**

**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin" **CREATIVE HEART FILMS " SH.P.K**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë**

Objekti i shoqërisë është prodhim filmave me metraz te shkurter dhe te gjate dhe distributimi duke perfshire cdo veprimtari tjeter te kesaj fushë te lejuar nga legjislacioni shqiptar .

**NENI 5**

**Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në rrethin e Tiranes, bashkia Tirane ;rruga Bajram Allaraj nd 145 h 1 ap 2 kodi postar 1001;

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 6**

**Kapitali i Shoqërisë dhe Ortaket**

Kapitali i shoqërisë është në vlerën.1. 000.000 (nje milion ) lek, 100 % Ortaku themelues Z Taulant Skëndaj te Shoqërisë Tregtare "**CREATIVE HEART FILMS " SH.P.K** te cilet zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:- Z Taulant Skëndaj , shtetase shqiptare, i datëlindjes 22/07/1982 lindur në Librazhd dhe banues ne rrethin e Tiranes, bashkia Tirane rruga Bajram Allaraj nd 145, H-1 ap-2 kodi postar 1001; , mbajtës i kartes se identitet me id I20722104S zotërues i kuotave të përbërë nga 10.000.000(dhjetë milion) lekë, duke përfaqesuar 100 %, të kapitalit shoqerise .



Kapitali themeltar do te shlyet plotesisht ne para nga Ortaket me themelimin e Shoqerise per nje periudhe 5 vjecare. Pergjegjesia e ortakeve shtrihet deri ne shumen e kontributeve te tyre ne kapitalin themeltar

#### **NENI 7 Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;  
Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

#### **NENI 8 Administratori**

Shoqëria administrohet nga 1 Administratore i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.  
Administratori i shoqërisë do të jetë Z Taulant Skëndaj shtetase shqiptare e datelindjes 22/07/1982 lindur në Librazhd, dhe banues ne rrethin e Tiranes, bashkia tirane rruga bajram Allaraj nd 145 h-lap-2; kodi postar 1001; Me mbajtes i leter me ID I20722104S shtetas Shqiptar,  
Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, te cili ushtronë këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 10**

Ortaket themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 11**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përrputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

#### **NENI 12**

Ortaket detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 13**

Mosmarëveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

#### **NENI 14**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkruan pa vërejtje. Ky Akt-Themelimi hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

### **ORTAKËT THEMELUES**

Taulant Skëndaj

Taulant Skëndaj